ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-2103-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Dizinfekta NRG SH.P.K.**
NUI	**811579393**
Adresa	**Rruga Kosturi, pn**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**048555558**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Drita Cina**
Adresa elektronike	**dizinfekta.nrg@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**24.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka inicuar procedurën e prokurimit me titull : Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës me numer prokurimi 616-24-2103-2-1-1.

Ne diten kur ka qene e planifikuar hapja, ka vendosur Anulimin e aktivitetit, dhe gjithashtu ka ngarkuar direkt formularin B10 Njoftimi

per anulim pa respektuar afatet kohore për ta kundërshtuar.

Si Operator Ekonomik me interes me kete procedure e kundershtojme fuqishem,dhe kerkojme anulimin e ketij vendimi.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datë 19.04.2024 si Operator me interes për këtë aktivitet të prokurimit, duke respektuar Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim.

Deri me sot kemi pritur nga ana e Autoriteti Kontraktues komuna Prishtinë për një përgjigje, mirëpo nuk e kemi marrë.

Për këtë arsye ne duke respektuar Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, konkretisht nenin 109, i drejtohemi Organit Shqyrtues të Prokurimit me Ankesën tonë kundrej vendimit të Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, konkretisht :
Neni 1 Qëllimi,
Neni 7Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur,
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës,
Neni 24 Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit ,
Neni 27 Dosja e Tenderit,
Neni 28 Specifikimet teknike,
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes,
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës,
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale si dhe Rregulloren Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik nenin Neni 17 Dosja e Tenderit pika 17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet nëmënyrë që a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE,
Neni 19 Specifikimet Teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: 3*4 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës* 616-24-2103-2-1-1. Autorteti

Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim me vlerë të parashikuar **900,000.00 €.**

Ne si palë me interes për këtë aktivitet të prokurimit, duke respektuar Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 108/A të këtij ligji, për zgjidhjen e mosmarrëshjeve, brenda afatit ligjor ju kemi drejtuar Autoritetit Kontraktues Komuna Prishtinës me Kërkesë për Rishqyrtim me datën 09.04.2024 me pretendimet tona ankimore kundër Dosjes se Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : *34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit : 616-24-2103-2-1-1.*

Duke u mbeshtetur ne B54 Formulari standart për korigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara të datës **29.03.2024** me kodin e dokumentit 2024/616-24-2103- 2-1-1/B54-0007501 nga ana e Autoritetit Kontraktues Komuna Prishtinë **Afati i fundit për pranim të tenderëve nga data 02.04.2024 ora 13:30 është shtyrë për datë 15.04.2024 në po të njejtën orë.** Pra data e hapjes ka qenë 15.04.2024.

Autoriteti Kontraktues edhe pse Kërkesën për Rishqyrtim e kishte pranuar me datë **09.04.2024,** respektivisht **08.04.2024** nga një tjetër Operator Ekonomik, nuk ka marrë VENDIM për Pezullim të aktivitetit deri me datën 15.04.2024 në ora 09:20, kur nga ana e Autoritetit Kontraktues ngarkohet një dokument me emërtimin **VENDIMI PER PEZULLIM - FORMULARII.pdf.**

Në këtë Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit, pika I e vendimit është:
I. PEZULLOHET aktiviteti i prokurimit me titull: "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1 dhe nr. të brendshëm

brendshëm 616-24-028-2-1-1 Autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës do të shqyrtoj kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik : KFP DDD., të datës 08.04.2024 dhe OE: Dizinfekta NRG SH.P.K, të datës 09.04.2024, brenda afatit prej tri (3) ditëve të punës i cili afat në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tri (3) ditë shtesë për çka do të informohet ankuesi

Me po të njejten datë 15.04.2024 (**dita kur ka qene e planifikuar hapja**) në ora **09.48** Autoriteti Kontraktues ngarkon një dokument tjetër në platëformën E-prokurimi me emertimin : ***VENDIM MBI KERKESEN PER RISHQYRTIM 15.04.2024.PDF***

Autoriteti Kontraktues na njofton se Kërkesat për Rishqyrtim janë refuzuar si të pabazuara, dhe vazhdon me orarin e planifikuar të hapjes. Kjo është shkelje e Ligjit të Prokurimit Publik si dhe rregullores 01/2022, konkretisht nenit *Neni 61 Pezullimi i aktivitetit të prokurimit*, respektivisht nenit *63.2. Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.*
Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0). 63.3 Kundër çdo vendimi të Autoritetit Kontraktues, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-se.

Ajo cka është e rendësishme në këtë vendim është arsyetimi, kur AK na njofton qe ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bejë vlersimin fillestar te pretendimeve ankimore:
Lidhur me pretendimet ankimore te "Dizinfekta NRG" Sh.P.K. duhet sqaruar se permes nenit 10 paragrafit 10.3 te RRPP eshte percaktuar se njesia kerkuese nder te tjera ka pergiegesine per te pergatitur detyren projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e references, paramasen dhe parallogarine. Në kite kontekst sektori i prokurimit ka kerkuar nga njesia kerkuese ge te bej vleresimin fillestar te pretendimeve ankimore. Ne perputhje me sqarimet e ofruara nga

njesia kerkuese esht getur se te gjitha kerkesat e percaktuara sipas aneksit 7 te dosjes se tenderit - pajisjet dhe mekanizmi i obligueshem si dhe ne aneksin 1 specifikimet teknike te detyrueshme janë ne perputhje te plotë fillimisht me nevojat e njesise kerkuese pastaj me gellimin e aktivitetit te prokurimit dhe mbi te gjitha me parimet themelore te prokurimit publik duke perfshire por pa u kufizuar ne parimin per mosdiskriminin/ mosfavorizim sipas nenit 7 te LPP si dhe nenit 28 të LPP.

Dhe saktësisht 28 minuta pas pezullimit, merr vendim per refuzim cka nenkupton qe nuk i ka trajtuar ankesat fare. Gjithashtu nuk ka respektuar afatin për pergjigje në Kërkesat për Rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, pas refuzimit të Kërkesave për Rishqyrtim ngarkon një dokument tjetër të cilin e emerton: ***Dokumenti shtojca 15.04.2024 12:15 VENDIM MBI ANULIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT.PDF*** Autoriteti Kontraktues në vendimin për anulim, në arsyetimin e VENDIMIT thirret se ka ndodhur një shkelje e ligjit qe nuk mund të rregullohet apo parandalohet.

Ne pretendojmë se ky është një gabim i qëllimshëm nga ana e Autoritetit Kontraktues, sepse shkelja me e madhe është Anulimi i këtij aktiviteti të Prokurimit, dhe mbi të gjitha ky arsyetim nuk qendron, dhe jemi të bindur që me veprimet e sajë Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka bëre shkelje te LPP-së dhe rregulloreve në fuqi.

Platëforma E-prokurimi e ka paraparë që mund të ndodhin gabime të tilla, të pa përfillshme dhe të riparushme. Autoriteti Kontraktues ka mundësi në platëformën E-prokurimi qe të ndryshoj dokumentin Përshkrimi i Çmimeve, ta plotësoj ashtu siq duhet dhe ta ngarkoj dokumentin e ri, gjithmonë nëse Autoriteti Kontraktues ka vërejtur që është ngarkuar dokumenti me ndonjë gabim, apo nuk përmban të gjitha informatat e nevojshme për çmime. Për me shumë, për Autoritetin Kontraktues dhe OSHP po e argumentojmë të gjithë hapat qe duhet ndjekur, pa shkelur

ligjin, perkundrazi duke respektuar në përpikëmeri.

I. Në rastin konkret për procedurën e lartëshënuar kur nuk është bërë ende hapja,ZPP ka mundësinë për të ndryshuar Përshkrimin e Çmimit pa patur nevojë të anuloj aktivitetin e prokurimit:

Në radhë të parë selektohet procedura e prokurimit, dhe vazhdojmë tek **Detajet**, Hapët një dritare e re e cila përmban të gjitha dokumentet dhe përshkrimet sa i përket këtij Aktiviteti të Prokurimit.

Tek Dosja, e cila gjindet në kuadër të kësaj procedure, AK përmes ZPP duhet të shtojë një dokument të ri dhe ky dokument duhet të përmbajë të deklaruar qartë të gjitha sqarimet për gabimin të cilin Autoriteti Kontraktues e ka verejtur tek Përshkrimi i Çmimeve. Për më shumë, kur ndodhin gabime tek përshkrimi i çmimeve, konsiderohen gabime të riparushme dhe të pa përfillshme, arsye kjo pse sistemi E-Prokurimi e ka paraparë një kolonë me emertimin Përshkrimi i Çmimeve(e cila na jep mundësine e ndryshimit të dokumentit qe gjendet brenda sajë).

Të njëjtën kohë, ZPP tek kolona Përshkrimi i Çmimit, duhet ta ngarkojë dokumentin e ri, të përmisuar dhe pastaj, përmes Formularit Standart B52 Korigjimit të Procedurës, të njoftoj për ndryshimet e bëra, arsyshmerin e tyre dhe gjithashtu të njoftoj për shtyrje të afatit për hapjse të ofertave, MINIMUMI 10 ditë nga data e publikimit të sajë në platëformën E-prokurimi. Përmes këtij Formulari Standart për Korigjimin e gabimeve do të njoftohen të gjithë

Operatorët Ekonomik të cilët kan pasur interes për për këtë aktivitet të prokurimit.
Ky dokumentet do të gjendet tek DOSJA, dhe të gjitha palët të cilët shprehin interes për këtë aktivitet kur të shkarkojnë dokumentin Përshkrimi i Cmimeve do ta shkarkojnë dokumentin e ri, të përmisuar i cili është ngarkuar nga ana e Autoriteti Kontraktues përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.

Pra të nderuar anëtarë të Panalit Shqyrtues të OSHP-së, zyrtarët e Autoritetit Kontraktues kanë bërë shkelje të njëpasnjeshme të kësaj procedure të Prokurimit, dhe nuk e dijmë nëse këto gabime janë të qëllimshme, apo nuk kan pasur njohur, por mbi të gjitha mbetet të shqyrtohen nga ana juaj dhe të merrni vendim meritor.

Përveq shkeljeve të shumta që Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka bëre gjatë këtij aktiviteti ka vazhduar edhe me tutje, duke shkelur Ligjin e Prokurimit të Republikës së Kosovës dhe të gjitha rregullorëve tjera në fuqi. Për më tepër, e drejta për Ankesë është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe gjithashtu edhe me ligjin e prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues ka anashkaluar afatet ligjore, të caktuara me Ligjet në fuqi, kur po të njëjtën ditë kur ka ngarkuar VENDIMIN MBI ANULIM përmës ZPP-së ka ngarkuar edhe formularin B10 Njoftimi për ANULIM, qe tek ne si Operatorë Ekonomik, sistemi E-prokurimi na ka njoftuar pas orës 00:00.

Në këtë rast AUTORITETI KONTRAKTUES pas vendimit për ANULIM(edhe sikur të ishte vendimi i vetëm dhe më i mirë, që në rastin konkret është vendimi më i gabuar), është dashur të respektoj afatet kohore qe janë të përcaktuara me LPP-në dhe rregulloret në fuqi.

Vetëm pas ditës se 5, duke llogaritur ditën e vendimit për anulim zero(ashtu siq e përcakton Ligji i Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me b10 Njoftimin për Anulim, sepse Operatorët Ekonomik kanë të drejtë të kundërshtimit përmës Kërkesës për Rishqyrtim. Edhe nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon Kërkesën për Rishqyrtim, ne si Operatorë Ekonomik e kemi të drejtën e garantuar nëse mendojmë që është vendim i gabuar dhe i pa drejtë, qe brenda 10 ditëve ta dergojmë në OSHP, duke respektuar nenin 109.

Të nderuar anëtarë të Panelit Shqyrtues, dëmi që mund të shkaktohet nga anulimi i këtij aktiviteti, është me i madh se sa një shtyrje siq e përcakton Ligji i Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës dhe rregulloret tjera në fuqi në afat prej 10 ditëve.

Gjithashtu, ne si Operatorë Ekonomik, përveq shkeljeve qe Autoriteti Kontraktues ka bërë para hapjes me anulimin e aktivitetit, qendrojmë në pretendimet tona sa i përket Dosjes se Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë: Autoriteti Kontraktues ne Dosje te Tenderit dhe Njoftimin per Kontrate ka specifikuar tek Aneksi 7: PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM

: *Pompë motorike – gjenerator UVL (vëllim Ultra i Ulët/Ultra Loë Volume) për dezinsektimin hapësinor të jashtëm., sasia 4 cope, Automjete pune për vendosjen e pompave gjeneratorëve ULV dhe pompave motorike për kryerje të shërbimit te dezinsektimit hapsinor të jashtëm. Automjetet duhet te jene paisura me GPS monitorues. (pick up ose kamionetë) sasia 6 copë*

Kjo kërkesë nga ana e Autoriteti Kontraktues sa i përket kontrollit të mushkonjave te rritura/adulte për komunën e Prishtinës ne mendojmë që është e gabuar. Në radhë të parë sistemi ULV (Volum ultra i ulët) shpërndan/sprucon produkte insekticide me një përqendrim të lartë të përbërësit aktiv dhe i mjergulluar ne shumë pak ujë. Ne kete rast prodhohet mbjegullimi shumë intensiv që arrin grimca disa mikronëshe (5-25 mikron) të cilat mund të devijohen lehtësisht nga rrymat e ajrit dhe të bëhen problem real për zonat ne afersi dhe ato të banuara. Kërkesa jonë konsiston që të perfshihen ne kryerjen e sherbimit te dizinsektimit edhe trajtime me pajisje me volum normal, siç ndodh në pjesën më të madhe të Evropës. Paisjet me volum normal (atomizator) sprucojne grimca me përmasa më të mëdha, të cilat janë me të qëndrueshme ndaj ndryshimeve të rrymave në ajrit dhe që mund të jenë më të orjentuara nga objektivi i kryerjes se trajtimit dhe me më pak propabilitet për të ndikuar në mjedis në rast gabimi.

Ne kërkojmë që të shtohet edhe mundësia e përdorimit të pajisjeve/atomizuesve të montuar ne pick up me një sistem të sprucimit me vëllim normale perveç pasijeve shpërndarse ULV.
Qasja e re ndaj kontrollit të mushkonjave të miratuar në BE dhe politikën e re që ECHA (Agjencia Kimike Europiane) po zbaton me ligjin e Biocideve. Aktualisht kjo strukture e specializuar e BE po rivlerëson të gjithë përbërësit aktivë insekticid dhe ata që jane aprovuar tashme e kanë humbur plotësisht përdorimin në hapesira te jashtme.

Me pak fjalë përdorimi i insekticideve që miratohen për të kaluar në biocide lejohen përdorimin vetem në hapsira të mbyllura ose zona të jashtëme të tyre ku ka plasaritje dhe çarje. Ndërsa përdorimi në hapësirat e gjelbra është i ndaluar. Arsyeja e mos lejimit të përdorimit kundër mushkonjave në ambiente të jashtme ka të bëj me faktin se me trajtimet aktuale hapësinore vriten të gjithë insektet e dobishme të pranishme dhe ndikimi në mjedis është jashtëzakonisht i lartë dhe afatgjatë. Për këtë arsye, të gjitha programet e zbatimit në kontrollin e mushkonjave nga shtetet apo autoritetet bashkiake apo rajonale nuk kryejnë më trajtime adulticide/insekticid, përveç rasteve të rreziqeve të rënda shëndetësore apo pandemive por në asnje rast për desinsektimin kundër mushkonjave.

Aktualisht në vendet e zhvilluar dhe pikerisht ne ato të BE, trajtimet e kontrollit të mushkonjave kryhen me trajtim larvicid duke percaktuar në hartë të gjitha vendet ku shumohen mushkonjat si dhe duke i inkorporuar ato me planet e kontrollit “door to door”.

Kurthet për kontrollin e larvicid dhe adulticide me një efektivitet prej të paktën 3 muajsh vendosen në zona me rrezik dhe/ose brenda zonave që do t'i nënshtrohen kontrollit. Bazuar në zhvillimet e mëdha qe kanë ndodhur së fundmi në fushën e kontrollit të mushkonjave në vendet evropiane dhe jo-evropiane (si psh Shqipërinë), kërkojmë të rishikohen këto kritere të projektit me kritere që respektojnë mjedisin, njerëzit dhe gjithë insektet e dobishëm. Kërkojmë ridizajnimin e programit pasi një bashki nuk mund të jetë përgjegjëse për shpërndarjen e insekticideve në mjedis kur është e mundur të zgjidhet problemi me një studim të saktë të territorit, hartëzimin e të gjitha vatrave të shumimit të larvave dhe duke vepruar në mënyrë të synuar dhe me produkte organike.

Duke u mbeshtetur në Ligjin NR. 08/L-065 PËR PRODUKTET BIOCIDE, Nenin 1, respektivisht pika 4. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren Nr. 528/2012/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2012 lidhur me vënien në dispozicion të tregut dhe përdorimin e produkteve biocide si dhe Direktiva e Bashkimit Europian BPD, respektivisht : The Biocidal Products Directive (BPD) also knoën as the Biocides Directive is European Union Directive, (98/8/EC), ëhich concerns biocides. It is officially knoën as Directive 98/8/EC of the European Parliament and of the Council of 16 February 1998 concerning the placing of biocidal products on the market.[1] In 2013 the Biocidal Products Directive ëas superseded by The Biocidal Products Regulation (BPR, Regulation (EU) 528/2012).

Kërkojmë që :

I.ANËKESA JONË të Aprovohet e bazuar

II. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës të anuloj vendimin mbi anulim të këtij aktiviteti, të bëje ndryshimet e nevojshme dhe të vazhdohet me procedurat tjera në vazhdimsi, në të mirë të interesit të përgjithshem, marrë për bazë qe nga këto mund të kemi dëme të pariparushme, për të cilat përgjegjesia bie direkt mbi Komunën e Prishtinës, në këtë rast në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jo materiale janë të shumta, sepse ZPP i Komunës së Prishtinës me gabime të qellimshme të LPP dhe Rregullores 001/2022, ka shkaktuar stres për ngarkimin e dosjes, kompletimin e dokumentacionit përkatës dhe cka jo tjetër. Për më tepër qellimi i tyre eshte zvarritja e kesaj procedure te prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*